



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

## Fjala hyrëse e Guvernatorit

10 tetor 2024

---

**Konferenca:** Takimi i 22<sup>-të</sup> i Konferencës Rajonale të Iniciativës për Mbikëqyrjen e Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE – ISI)

**Organizator:** Iniciativa Evropiane për Mbikëqyrjen e Sigurimeve

**Nikoqir:** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

**Koha dhe vendi i takimit:** Hotel Swiss Diamond, Bulevardi Nënë Tereza p. n.- 10000 Prishtinë, Kosovë

---

*I nderuari z. Peter Braumüller, drejtor menaxhues për Mbikëqyrje të Sigurimeve dhe Pensioneve në Autoritetin Austriak të Tregut Financiar,*

*I nderuar Zëvendës Guvernator Cakaj,*

*Të nderuar përfaqësues të Autoriteteve Rregullatore të Sigurimeve,*

*Zonja dhe zotërinj,*

*Me kënaqësi të madhe ju dëshiroj mirëseardhje në Prishtinë në Takimin e 22<sup>-të</sup> të CESEE-Iniciativës Evropiane për Mbikëqyrje të Sigurimeve – ISI (për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore).*

*Para se të vazhdoj me fjalën time hyrëse, do të doja të shprehja falënderim të veçantë për z. Peter Braumüller dhe për tërë ekipin e angazhuar në organizimin e kësaj ngjarjeje.*

*Z. Braumüller, udhëheqja juaj vazhdon të jetë vendimtare në mbajtjen e kësaj nisme të suksesshme. Angazhimi juaj për ta kultivuar bashkëpunimin dhe ndarjen e njohurive mes komunitetit tonë të larmishëm është vërtet i admirueshëm dhe u jemi mirënjohës për përpjekjet tuaja!*

*Kjo ngjarje shënon një moment historik të rëndësishëm, jo vetëm për Kosovën, por edhe për rajonin e Evropës Qendrore Lindore dhe Juglindore, pasi që ne jemi bashkuar nën synimin e përbashkët për rritjen e mbikëqyrjes së sigurimeve dhe bashkëpunimit ndërkufitar. Që nga fillimi i tij në vitin 2011, takimi është dëshmuar të jetë një platformë me vlerë shumë të çmuar për rregullatorët e sigurimeve, ku ata janë në gjendje që të shkëmbejnë njohuri, që të ndajnë përvoja dhe që të diskutojnë rreth çështjeve urgjente në mbikëqyrjen e sigurimeve.*

*Sot, kur po takohemi për herë të parë në Kosovë, vazhdojmë ta nderojmë këtë traditë të mrekullueshme të bashkëpunimit, ndarjes së njohurive, por edhe kolegjalitetit. Është një privilegj të presësh një grup kaq të larmishëm profesionistësh të përkushtuar dhe të dedikuar për ta përmirësuar mbikëqyrjen dhe për ta forcuar kornizën tonë rregullatore dhe për ta garantuar integritetin e tregjeve tona të sigurimeve.*

*Ky vit është veçanërisht i veçantë për ne; pasi që Banka Qendrore e Republikës së Kosovës feston me krenari 25 vjetorin e saj. Të qenit nikoqir i forumit përputhet në mënyrë të përkryer me ngjarjet tona të përvjetorit dhe ne besojmë se ky rast përputhet me frymën e takimit tonë - një festë e rritjes, qëndrueshmërisë dhe përkushtimit ndaj vlerave të përbashkëta, si dhe atyre të ndara mes nesh.*

*Do të doja të nënvizoja shkurtimisht progresin e rëndësishëm që e kemi bërë në sektorin tonë të sigurimeve, veçanërisht nëpërmjet reformave specifike të cilat i kemi zbatuar me sukses me synimin për ta rikthyer pozitën financiare të sektorit tonë të sigurimeve. BQK-ja si rregullatore dhe mbikëqyrëse i ka adresuar me sukses sfidat e shërbimit gjatë zbatimit të masave të kujdesshme për t'i zgjidhur ato çështje dhe për t'u siguruar që sektori të funksionojë sipas rregullave dhe t'i mbrojë të siguruarit ose përfituesit si dhe viktimat.*

*Duke i pasur parasysh të gjitha masat e rëndësishme që i kemi ndërmarrë, duke përfshirë forcimin e kornizës sonë rregullatore, këto përpjekje e kanë hapur rrugën rritjes dhe qëndrueshmërisë së mëtejshme si dhe rritjes së besimit të konsumatorit.*

*Ne jemi të përkushtuar për ta avancuar kornizën rregullatore dhe mbikëqyrëse të industrisë së sigurimeve që të jetë në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të BE-së.*

*Ne e kemi marrë Udhërrëfyesin për Aftësi Pagueuse II nga Banka Botërore, i cili është një projekt ambicioz, sfidues dhe kërkues. Kjo do të thotë se ne po kalojmë gradualisht nga mbikëqyrja thjesht e bazuar në pajtueshmëri në mbikëqyrje të kujdesshme e të bazuar në rrezik. Ky tranzicion apo kalim përfshin gjithashtu prezantimin edhe të një doracaku mbikëqyrës i bazuar në rrezik, me mbështetjen e FMN-së.*

*Ne e kemi marrë edhe udhërrëfyesin për SNRF 17. Zbatimi i Aftësisë Pagueuse II dhe SNRF 17 në vendet tona të rajonit mund të jetë sigurisht një sfidë e rëndësishme, për të cilën do të kemi mbështetjen e Bankës Botërore.*

*Ne jemi duke punuar në rritjen e mbikëqyrjes së sjelljes së tregut në mesin e institucioneve tona financiare, duke siguruar që BQK-ja t'i ketë kompetencat dhe burimet adekuate për ta zbatuar një mbikëqyrje efektive. Kohëve të fundit, ne e krijuam Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve*

*për ta përmirësuar mbështetjen për konsumatorët financiarë. Brenda këtij departamenti, e kemi krijuar një divizion të dedikuar dhe të fokusuar në sjelljen e tregut.*

*Në sektorin tonë dhe në shumicën e juridiksioneve në rajon, Autopërgjegjësia ndaj Palëve të Treta (Motor Third Party Liability MTPL) vazhdon të luajë një rol dominues në tregun e sigurimeve. Derisa MTPL-ja është thelbësore për ta ofruar mbulim bazë dhe për ta mbrojtur konsumatorët nga detyrimet që rrjedhin nga përdorimi i automjeteve, si rregullatorë ne e njohim rëndësinë e llojllojshmërisë së portfolios së sigurimeve për ta rritur stabilitetin e përgjithshëm financiar. Prandaj, ne jemi të përkushtuar që ta rrisim përqindjen e produkteve vullnetare të sigurimit jo-jetë dhe sigurimit jetë.*

*Aktualisht, Kosova është i vetmi vend evropian që nuk është anëtar i sistemit të Kartonit të Gjellbër, përkundër përpjekjeve tona të vazhdueshme për anëtarësim. Prandaj, siguruesit tanë nuk mund ta lëshojnë Karton të Gjellbër dhe automjetet nga shumica e vendeve evropiane që hyjnë në Kosovë duhet të blejnë MTPL kufitare në kufi për qëndrimin e tyre. Edhe pse Kosova zyrtarisht ka aplikuar për t'iu bashkuar sistemit të Kartonit të Gjellbër, ky aplikim ka rezultuar të jetë i pasuksesshëm. Ndërkohë që është bërë progres në përmbushjen e shumë kritereve për anëtarësim, anëtarësimi në Këshillin e Byrove mbetet hapi që duhet arritur. Trajtimi i kësaj çështjeje është i rëndësishëm për përmirësimin e mbulimit të sigurimeve ndërkufitare, mbështetjen e lëvizjes së lirë të njerëzve si dhe kapitalit dhe përafrimin e Kosovës me standardet rajonale të sigurimeve. Këtu, të nderuar pjesëmarrës dhe të ftuar, nevojitet mbështetja e institucioneve tuaja dhe vendeve të pasuara.*

*Ekipi ynë do t'ju ofrojë njohuri më të detajuara mbi këto zhvillime sot më vonë dhe ju inkurajoj që fuqimisht të angazhoheni me ta për këtë temë të rëndësishme.*

*Si Bankë Qendrore ne e njohim rëndësinë e bashkëpunimit të fortë me rregullatorë dhe mbikëqyrës të tjerë financiarë. Puna së bashku na lejon të sigurojmë stabilitetin dhe sigurinë e sistemeve tona financiare. Duke i koordinuar përpjekjet, shkëmbimin e informatave dhe përafrimin e politikave, ne mund të i menaxhojmë më mirë rreziqet dhe ta mbështesim rritjen e qëndrueshme në ekonominë tona.*

*Dhe së fundi, derisa e nisim këtë rrugëtim së bashku, le t'i përkrahim mundësitë që i kemi përpara. Ne kemi një agjendë intensive, e mbushur me diskutime rreth sfidave aktuale në mbikëqyrjen e sigurimeve dhe një vizion për të ardhmen tonë të përbashkët. Unë e inkurajoj secilin prej jush që të angazhohet në mënyrë aktive, t'i ndajë njohuritë tuaja dhe të krijojë lidhje që do të shtrihen edhe përtej këtij takimi.*

*Duke punuar së bashku, ne mund ta forcojmë angazhimin tonë për ta avancuar kornizën rregullatore dhe atë mbikëqyrëse të sigurimeve drejt një sektori më të integruar dhe më të qëndrueshëm financiar në rajonin tonë.*

*Edhe një herë, ju faleminderit që keni ardhur këtu dhe le ta bëjmë këtë takim të suksesshëm!*